Në këtë komunë, por në një banesë tjetër ose vend bashkëjetese (p.sh. shtëpi të afërmish ose miqsh, kazermë, spital) 2

Në një komunë tjetër italiane 3

Jashtë shtetit 4

3.2 Shënoni nëse gjatë 12 muajve të fundit (21 tetor 2000 - 21 tetor 2001) personi ka jetuar në këtë banesë gjithsej (edhe pse jo në mënyrë të vazhdueshme)

Deri në 90 ditë ..... 1 ➔ pyetësori mbaron këtu

Nga 91 deri 180 ditë 2

Nga 181 deri 270 ditë 3

Nga 271 deri 365 ditë 4

Nëse ka jetuar në këtë banesë më shumë se 90 ditë

3.3 Shënoni arsyen kryesore të përdorimit të kësaj banese

Punë ..... 1 Prani familjarësh ..... 3 Tjetër 5

Studim ..... 2 Pushime ..... 4 ➔ pyetësori mbaron këtu

Kush është 15 vjeç ose më tepër përgjigjet duke filluar nga pika 4; kush është më pak se 15 vjeç përgjigjet duke filluar nga pika 5

4. Gjendja profesionale ose jo profesionale dhe veprimtaria e punës

4.1 Shënoni nëse javën para datës së regjistrimit (nga 14 më 20 tetor 2001), personi ishte

I punësuar 1

Në kërkim pune 2

Student 3

Shtëpiak 4

I dalë nga puna 5

Në shërbim ushtarak ose në shërbim civil zëvendësues 6

I paaftë për punë 7

Në gjendje tjetër 8

} shkoni në pikën 5

4.2 Shënoni sektorin e veprimtarisë në kuadrin e të cilit personi ka punuar

Bujqësi e peshkim 1

Industri (nxjerrje mineralesh, industri e përpunimit, energji elektrike, gaz e ujë) 2

Ndërtime e instalime impiantesh 3

Tregti, riparime, shërbime publike, transporte, komunikacione 4

Kredi, sigurime, shërbime të tjera për prodhimin dhe/ose konsumin 5

Shërbime shoqërore e për personat duke përjashtuar shërbimet shtëpiake pranë familjeve e bashkëjetesave (p.sh. administrata publike, arsimi, shëndetësia) 6

Shërbime shtëpiake pranë familjeve e bashkëjetesave (p.sh. bashkëpunëtor familjar, kopshtar, shofer, roje, baby-sitter) 7

Organizma ndërkombëtare e të Vendeve të tjera (p.sh. OKB, FAO, ambasadat në Itali) 8

5. Vendi i studimit ose i punës

5.1 Shënoni nëse personi shkon çdo ditë në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës

Po, shkon në vendin e studimit (përfshi çerdhen, kopshtin e kurset e kualifikimit profesional)..... 1

Po, shkon në vendin e punës 2

} shkoni në pyetjen 5.2

Jo, sepse studjon në banesën e vet 3

Jo, sepse punon në banesën e vet 4

Jo, sepse nuk ka një vend të qëndrueshëm pune (agjent tregtar, përfaqësues, etj.)..... 5

Jo, sepse nuk studjon ose nuk punon ose nuk frekuenton kurse kualifikimi profesional 6

} Pyetësori mbaron këtu

5.2 Shënoni nga cila banesë personi shkon në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës

Nga kjo banesë 1

Nga një banesë e ndryshme nga kjo..... 2 → pyetësori mbaron këtu

Nëse shkon nga kjo banesë

5.3 Shënoni nëse personi kthehet çdo ditë në këtë banesë nga vendi i zakonshëm i studimit ose i punës

Po 1

Jo ..... 2 → pyetësori mbaron këtu

5.4 Shkruani për së gjati emrin dhe adresën e vendit të zakonshëm të studimit ose të punës

[Punonjësit-studentë duhet të shënojnë emrin dhe adresën e vendit të punës. Ai që ushtron profesionin në mjete transporti (shoferë, punonjës të hekurudhave, punonjës në një linjë tramvajesh, pilotë, marinarë, etj.) duhet të shënojë emrin dhe adresën nga ku fillon punën (parkim, stacion, depozitë, aeroport, port, etj.)]

Emri i shkollës, ndërmarrjes, zyrës, entit, etj .....

Adresa e shkollës, ndërmarrjes, zyrës, entit, etj .....

.....

Në këtë komunë 1

Në një komunë tjetër italiane ..... 2 → saktësoni komunën

Jashtë shtetit ..... 3 → saktësoni shtetin e huaj → saktësoni siglën e provincës

Kush ka shkuar në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës <u>të mërkurën e kaluar</u> u përgjigjet pyetjeve 5.5, 5.6 e 5.7

5.5 Shënoni në çfarë ore personi ka dalë për të shkuar në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës

: (p.sh. 07.30)

orë minuta

5.6 Shënoni kohën e harxhuar për të shkuar (vetëm në vajtje) në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës

[Nëse personi ka shoqëruar fëmijët në shkollë para se të shkojë në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës, merrni parasysh të gjithë kohën e harxhuar.]

Deri në 15 minuta 1

Nga 16 deri në 30 minuta 2

Nga 31 deri në 45 minuta 3

Nga 46 deri në 60 minuta 4

Më shumë se 60 minuta 5

E rezervuar për Zyrën komunale të regjistrimit

5.7 Shënoni mjetin e transportit të përdorur për të bërë pjesën më të gjatë (nga pikëpamja e largësisë e jo të kohës) të rrugës nga banesa në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës

Tren 01

Tramvaj 02

Metro 03

Autobus urban, trolejbus 04

Autobus linje, autobus ekstraurban 05

Autobus i ndërmarrjes ose i shkollës..... 06

Automjet privat (si shofer) 07

Automjet privat (si pasagjer) 08

Motoçikletë, çiklomotor, motor 09

Biçikletë 10

Mjet tjetër (anije, teleferik, etj.) 11

Në këmbë 12

Shënime për plotësimin

1. Seksionet I, II e III të Fletës së familjes ndahen në "pika" që përmbajnë disa pyetje. Ju lutemi të lexoni me vëmendje çdo pyetje të veçantë, përfshirë shënimet e theksuara ose të shkruajtura në kllapa.
2. Kjo Fletë e familjes është përgatitur për leximin optik me skaner që nuk i dallon disa ngjyra, prandaj ju lutemi të përdorni vetëm një stilolaps të zi ose blu për të plotesuar kutitë. **MOS përdorni lapsa, as stilolaps me ngjyrë të kuqe ose jeshile, as flamastër.**
3. Në qoftë se një pyetje nuk ka të bëjë me ju (p.sh.sepse u drejtohet vetëm fëmijëve të moshës më pak se 6 vjeç) mos shënoni me kryq asnjë kuti e mos bëni shenja ose të shkruara të asnjë lloji.
4. Për çdo pyetje shënoni me kryq vetëm një kuti, përveç rasteve ku tregohet shprehimisht se pranohen më shumë se 1 përgjigje.
5. Për pjesën më të madhe të pyetjeve mjafton të shënohet me një kryq të vogël kutia që i përket rastit tuaj. (**Shënim:** është shumë e rëndësishme të mos bëhen shenja në kutitë e tjera!)

   P.sh. ……..

   Bashkëshort i atij që kryeson në fletën e familjes..... 02 ☒

   Nëse keni gabuar në përgjigje mbusheni kutinë përkatëse e shënoni me një kryq kutinë që i përket rastit tuaj.
6. Në pyetjet e tjera duhen shkruar numra ose fjalë sa më qartë që të jetë e mundur, me shkronja të mëdha dhe duke vënë vetëm një shkronjë për kuti. Shkronjat duhet të jenë të shkëputura njëra nga tjetra. Ju lutemi evitoni të shkruani jashtë kutive të destinuara për përpilimin.

A B C D E F G H I J K L M N O P Q R S T U V W X Y Z
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

Shembull plotësimi i saktë

0 6 / 0 2 / 1 9 5 4 (dita / muaji / viti)

S A N G I M I G N A N O

Po ☒
Jo ☐

Shembull plotësimi i gabuar

0 6 / 0 2 / 1954 (dita / muaji / viti)

San. Gimignano

Po ☐
Jo ☒

Shëmbuj gjatë plotësimit ku zakonisht gabohet

7 (JO)	2 (PO)	Shkronja shumë të mëdha
4 (PO)	4 (JO)	Numri 4 duhet lënë i hapur në pjesën sipër
1 (PO)	1 (JO)	Numri 1 duhet të shkruhet pa vijën e vogël poshtë
6 (jO)	9 (jO)	' (jO) — Mbyllini numrat e rrumbullakët, si 0, 6 e 9
L (jO)	E (jO)	F (jO) — Bashkoni vijat e shkronjave veçanërisht në shkronjat si E dhe F

JU FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN TUAJ

E nderuara Zonjë, I nderuar Zotëri,

Instituti kombëtar i statistikës po zhvillon Regjistrimin e 14-të të përgjithshëm të popullsisë dhe Regjistrimin e përgjithshëm të banesave të parashikuar në nenin 37 të i ligjit nr. 144 të 17 majit 1999 dhe të përfshirë në Programin statistikor kombëtar në radhën statistikave të konsideruara të nevojshme për Vendin.

Regjistrimet kryhen në pjesën më të madhe të vendeve të botës për të numëruar banuesit e për të mbledhur informacione për karakteristikat e tyre shoqërore dhe ekonomike. Në Itali regjistrimi bëhet çdo dhjetë vjet me objektivin e njohjes më të mirë të realitetit italian në nivel territorial shumë të detajuar. Regjistrimi i përgjithshëm i banesave, që përmbledh edhe regjistrimin e ndërtimeve, synon të japë informacione për sasinë e për karakteristikat e tyre.

Informacionet e përftuara lejojnë ndërtimin e një pasurie informative me rëndësi thelbësore për shoqërinë e për operatorët publikë, për të programuar e planifikuar veprimtaritë e ofertën e shërbimeve, edhe në nivel komunal e nënkomunal.

Ju lutemi të përpiloni me saktësi Fletën e familjes duke lexuar me vëmendje udhëzimet e bashkëngjitura.

Një anketues i ngarkuar nga Zyra komunale e regjistrimit do të paraqitet pranë banesës suaj, për të tërhequr pyetësorin e plotësuar nga ju.

Për garancinë Tuaj dëshiroj t'ju informoj se Istati është i detyruar t'i përdorë të dhënat e nxjerra vetëm për qëllime statistikore. Ato nuk mund t'u jepen institucioneve ose personave të tjerë dhe do te botohen në formë tabelash e në mënyrë të tillë që të mos mund të nxirret asnjë referim individual.

Ju kujtoj gjithashtu, se të dhënat e mbledhura me këtë kërkim mbrohen nga dispozitat për sekretin statistikor të d.l. nr. 322/89 dhe i nënshtrohen rregullave të përcaktuara për të mbrojtur konfidencialitetin e përgjigjeve sipas ligjit nr. 675/96 sëbashku me ndryshimet e plotësimet e mëtejshme. Pra të gjithë punonjësit dhe zy-rat publike të përfshira në aktivitetin e regjistrimit duhet të respektojnë sekretin e nuk mund të përdorin të dhë-nat për qëllime statistikore.

Në përputhje me ligjin nr. 675/96 titullari i vrojimit është Istat-i dhe përgjegjës i saj është Drejtori i Departamentit të Statistikave Shoqërore. Janë, gjithashtu, përgjegjës për fazat përkatëse të kompetencës drejtuesit e Zyrave provinciale të regjistrimit të Dhomave të tregtisë e drejtuesit e Zyrave komunale të regjistrimit.

Sqarime eventuale mund te kërkohen nëpërmjet Numrit Jeshil të posaçëm **800-294 294**, çdo ditë nga ora 9.00 deri në orën 22.00. Telefonatat duhen kryer nga një telefon i rrjetit fiks.

Duke gjetur mbështetje në gatishmërinë tuaj për një përfundim të mbarë të këtij evenimenti të rëndësishëm, ju falënderoj që tani juve e familjarët tuaj për bashkëpunimin e çmueshëm. Me përshëndetjet më të mira

Presidenti i Istat-it
Luigi Biggeri

REFERIME LIGJORE

– Ligji i 17 majit 1999, nr. 144, neni 37 "Dispozita në fushën e regjistrimeve" dhe rregullorja përkatëse e zbatimit të Regjistrimit të Përgjithshëm të 14-të të popullsisë, të Regjistrimit të përgjithshëm të banesave dhe të Regjistrimit të përgjithshëm të industrisë e të shërbimeve.
– D.P.R. i 30 majit 1989, nr. 223 dhe ndryshimet e plotësimet e mëtejshme - "Miratimi i rregullores së re për gjendjen civile të popullsisë banuese" nenet 3 (popullsia banuese), 11 (fshirje nga regjistri i gjendjes civile) dhe 46 (rishikimi i regjistrit të gjendjes civile).
– Dekretligji i 6 shtatorit 1989, nr. 322 dhe ndryshimet e plotësimet e mëtejshme - "Rregulla për Sistemin statistikor kombëtar e për organizimin e Institutit kombëtar të statistikës" - nenet 6bis (trajtimi i të dhënave personale), 7 (detyrimi për dhënien e të dhënave statistikore), 8 (sekreti i zyrës për të ngarkuarit në zyrat e statistikës), 9 (dispozita për mbrojtjen e sekretit statistikor), 11 (sanksione administrative në rast përgjigje të munguar), 13 (programi statistikor kombëtar).
– Ligji i 31 dhjetorit 1996, nr. 675 dhe ndryshimet e plotësimet e mëtejshme -"Mbrojtja e personit dhe e subjekteve të tjera lidhur me trajtimin e të dhënave personale".
– Dekret i Kryetarit të Këshillit të Ministrave i 31 marsit 2000 - "Program statistikor kombëtar për trevjeçarin 2000-2002" (shtojcë e zakonshme në Gazetën Zyrtare nr. 114 të 18 majit 2000).
– Dekret i Presidentit të Republikës i 2 qershorit 2000 - "Lista e vrojtimeve me detyrim përgjigjeje për subjektet private" (Gazeta Zyrtare, nr. 180 e 3 gushtit 2000).

ISTITUTO POLIGRAFICO E ZECCA DELLO STATO

SISTEMI STATISTIKOR KOMBËTAR
INSTITUTI KOMBËTAR I STATISTIKËS

ISTAT

Regjistrimi i 14-të i përgjithshëm i popullsisë dhe regjistrimi i përgjithshëm i banesave

21 tetor 2001

(Ligji i 17 majit 1999, nr. 144, neni 37)

Udhëzim për plotësimin e fletës së familjes

SEKSIONI I – TË DHËNA PËR BANESËN

1. Pronësia

Pyetja 1.1

• Shënoni me kryq përgjigjen 1 në rast se banesa është pronësi eskluzive ose e përbashkët e të paktën një kit prej personave që banojnë aty. Shënoni me kryq përgjigjen 1 edhe kur jetohet në banesë me të drejtë perdorimi, ose duke gëzuar njërit drejtë tjetër reale (për shembull përdorim, banesë) ose kur banesa është objekt shpengimi, ose për faktin se është shitur vetëm pronësia pa të drejtën e përdorimit për banim, si edhe në rast se pronari jep me qira pjesë të shtëpisë së tij duke vazhduar të banojë aty.

• Shënoni me kryq kutitë 2 ose 3 kur banesa nuk është pronë e asnjë prej personave që banojnë aty, por e marrë me qira (kutia 2), ose e zënë ne formë tjetër (kutia 3), domethënë gratis, ose në cilësinë e një shërbimi.

Pyetja 1.2

• Pavarësisht nga përgjigjja dhënë pyetjes 1, cilësoni cili është pronari i banesës midis atyre të radhitur në listë. Në rast se pronari nuk është askush prej këtyre, shënoni me kryq kutine 8. Në qoftë se pronësia është e përbashkët midis disa subjekteve (privatë, ndërmarrje, etj.), tregoni pronarin që zotëron kuotën më të madhe të pronësisë. Në rast pronësie pa të drejtën e përdorimit, tregoni pronarin e pronësisë pa të drejtën e përdorimit.

2. Struktura e banesës

Pyetja 2.1

Shënoni numrin e përgjithshëm të dhomave të banesës, edhe ato me hyrje të pavarur që nga pikëpamja funksionale janë në lidhje me trungun kryesor të banesës.

Nuk duhen llogaritur banjat, kuzhinat, kuzhinat e vogla, kthinat plotësuese dhe shtojcat. Duke bërë këtë llogaritje duhet patur parasysh se një banesë e madhe e me shumë pjesë me funksione të ndryshme, ose e ndarë në dy ose më shumë hapësira nga harqe ose nga ndarës të lëvizshëm, duhet llogaritur jo vetëm si dhomë e vetme, por si disa dhoma.

Duhen llogaritur edhe dhomat me aneks për gatim që janë të destinuara për përdorime të ndryshme.

• Me **dhomë** kuptohet një dhomë që merr ajër e dritë të drejtpërdrejtë nga jashtë dhe që ka përmasa të tilla sa të lejojë vendosjen e një shtrati duke lënë hapësirën e nevojshme për lëvizjen e një personi. Janë dhoma për shembull dhomat dhe dhoma e ndenjes në qoftë se i përgjigjen karakteristikave e lartpërmendura. Kuzhinat, kuzhinat e vogla, kthinat plotësuese dhe banjat nuk duhen llogaritur si dhoma, edhe pse mund t'i kenë karakteristikat e saj.

• Me **dhomë me hyrje nga jashtë** kuptohen ato që kanë një hyrje të pavarur nga të tjerat që formojnë trungun kryesor të banesës e që janë fizikisht të ndara nga ai. Megjithatë këto dhoma janë nga pikëpamja funksionale plotësuese për banesën e përdoren nga të njëjtet persona që jetojnë aty.

• **Shtojcat** janë bodrumet, nënçatitë, garazhet, etj., domethënë hapësirat e destinuara dhe efektivisht të përdorura për një kohë të gjatë në shërbim të banesës (edhe nëse nuk i përkasin të njëjtës doret, banjat, dhomat e zhveshjes, skutat, etj.

• Me **kuzhinë** kuptohet një hapësirë dhome (ose pjesë e saj) e pajisur me sistem për gatimin e ushqimeve dhe me impiant të palëvizshëm për pastrimin e enëve të kuzhinës, e përdorur për këto qëllime pavarësisht nga fakti se përdoret edhe për të ngrënë, për të fjetur ose për veprimtari të tjera. Në funksion të përmasave e të përdorimit të dhomës ku gatuhet, përcaktohen tre tipologji:

a) **kuzhina me karakteristika dhome**: është rasti i kuzhinës "tradicionale", e përdorur dhe e pajisur kryesisht për të gatuar e për të ngrënë e me përmasat e një dhome (shih përkufizimin);
b) **kuzhinë e vogël**: është një kuzhinë me përmasa të reduktuara, nën përmasat minimale të dhomës, gati gjithnjë e mjaftueshme vetëm për vendosjen e impianteve të nevojshme;
c) **aneks për gatim në dhomë të destinuar për shumë veprimtari**: është rasti i dhomave të mëdhaja të përdorura për ngrënie, si dhe për sallë të vogël ngrënieje, ose në të cilën një pjesë i dedikohet vendosjes së impianteve të kuzhinës. Një dhomë e ndërtuar në mënyrë të tillë nuk është kryesisht një kuzhinë, por një dhomë për përdorime të ndryshme.

Pyetja 2.2

• Tregoni sa dhoma midis atyre të shënuara në pyetjen e mëparshme janë për përdorim profesional (si studioja e një profesionisti të lirë, zyra e një punëtori autonom, laboratori i një artizani e çfarëdolloj dhome në të cilën ushtrohet vetëm një profesion ose një zanat).

Pyetja 2.3 *(për përkufizimet shiko pyetjen 2.1)*

• Përgjigjuni pyetjeve a), b) dhe c) duke shënuar "0" (zero) ose "Jo" në qoftë se nuk disponohet lloji i kuzhinës në fjalë brenda banesës ose në dhomat me hyrje të veçuar. Në pikën c) kërkohet të shënoni nëse në banesë ekzistojnë dhoma me aneks për gatim, të cilat natyrisht do të jenë llogaritur më parë në pyetjen 2.1 te dhomat.

Pyetja 2.4 *(për përkufizimet shiko pyetjen 2.1)*

• Nuk duhen konsideruar në llogaritjet e niveleve shtojcat eventualet banesës (si bodrume, garazhe e nënçati) e dhomat me hyrje të veçuar. Ndërsa nënçatitë e banueshme e të tjera të ngjashme si këto, të përftuara në brendësi të banesës, përbëjnë një nivel e duhen llogaritur si të tilla. Numri i niveleve nuk duhet ngatërruar me numrin e kateve te ndërtesës në të cilën gjendet banesa. Shënoni me kryq kutinë 1 kur banesa shtrihet vertikalisht (si në rastin e banesave "me kulla" ti-pike e disa qendrave historike ose të shtëpive të ndërtuara me nënçati.

Pyetja 2.5 *(për përkufizimet shiko pyetjen 2.1)*

• Tregoni në metra katrorë të rrumbullakuar (pa dhjetorë) sipërfaqen e brendshme të banesës, ose sipërfaqen e dyshemesë duke hequr muret e duke përjashtuar vetëm shtojcat. Në qoftë se banesa shtrihet në disa nivele, ose përmbledh edhe dhoma me hyrje nga jashtë, duhet bërë shuma e sipërfaqes së të gjitha pjesëve.

3. Impianti higjieno sanitar e uji i pijshëm

Pyetja 3.1 *(mund të jepet më shumë se 1 përgjigje)*

• Shënoni cili është burimi i ardhjes së ujit të pijshëm në dispozicion të banesës, në brendësi të saj ose në dhomat me hyrje të ndarë, ose disponueshmëria eventuale vetëm e ujit jo të pijshëm. Në qoftë se banesa ka disa burime furnizimi, shënojini të gjitha.

• Shënoni me kryq kutinë 3 në qoftë se uji i pijshëm vjen nga një burim i ndryshëm nga ujësjellësi ose pusi: për shembull një burim jo i drejtpërdrejtë si një rezervuar i mbushur në mënyrë të herëpashershme.

• Shënoni me kryq katrorin 4 në qoftë se banesa ka vetëm ujë jo të pijshëm.

Pyetja 3.2

• Për **vaskë banje dhe dush** kuptohen ato pajisje që janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme me impiantin e ujit e me një impiant për shkarkimin e ujrave që rrjedhin përsëri, brenda banesës ose në dhomat me hyrje të veçantë.

• Përgjigjuni duke patur parasysh që vaska e banjës e dushi të ndara midis tyre e të vendosura në të njëjtën dhomë duhen konsideruar si dy impiante dhe që vaska e banjës në të cilën përfshihet edhe impianti i dushit duhet konsideruar si impiant i vetëm.

Pyetja 3.3

• Me **banjë** kuptohet një WC i lidhur në mënyrë të qëndrueshme me impiantin e ujit e me atë për shkarkimin e ujrave që rrjedhin përsëri, brenda banesës ose në dhomat me hyrje të veçantë.

Pyetja 3.4

• Me disponueshmëri të ujit të ngrohtë (për përdorim higjieniko-sanitar në banjë e në kuzhinë: uji i ngrohtë sanitar) kuptohet ai i ngrohur nga një impiant i palëvizshëm e jo nga furnella ose nga sisteme të tjera ngrohjeje.

Pyetja 3.5

• Përgjigjuni "Po" kur uji i ngrohtë furnizohet nga i njëjti impiant ngrohës i banesës. Përgjigjuni "Jo" në qoftë se uji i ngrohtë përftohet nga një impiant i ndarë, si skaldabanja me gaz ose elektrike.

Pyetja 3.6 *(mund të jepet më shumë se 1 përgjigje)*

• Përgjigjuni vetëm në rastin kur impianti i prodhimit të ujit të ngrohtë është i ndarë nga ai i ngrohjes.

4. Impianti i ngrohjes

Pyetja 4.1 *(mund të jepet më shumë se 1 përgjigje)*

• Me **impiant të centralizuar** kuptohet ai që shërben për ngrohjen e të gjitha banesave të pranishme në ndërtesë, por i vendosur jashtë një banese të vetme, për shembull në dhomat e shërbimit të ndërtesës (bodrume, kat përgjysmë nën tokë, etj.). Konsiderohet i centralizuar edhe impianti i lidhur me një rrjet telengrohës të qytetit.

• Me **impiant të palëvizshëm autonom** kuptohet ai që shërben për ngrohjen e një banese të vetme dhe i vendosur normalisht brenda saj ose në afërsi (për shembull kaldaja mund të gjendet në një kthinë të brendshme të posaçme, ose në ballkon/tarracë; panelet diellore mund të gjenden në çati, e kështu me radhë), përdorimi i së cilës administrohet në mënyrë autonome.

• Me **pajisje të veçanta të palëvizshme** kuptohen ato jo të lidhura me një impiant të centralizuar ose të palëvizshëm autonom, dhe që nuk janë të transportueshme: për shembull oxhakët, kaloriferët individualë të palëvizshëm me gaz, pompat e ngrohjes, piastrat elektrike, sobat me qymyrguri, me dru, me kerozen, me gaz nafte të lëngëzuar).

• Shënoni me kryq kutinë 5 ("Nuk ka…") në rast se nuk ekziston asnjë lloj ngrohjeje, ose ekzistojnë pajisje të lëvizshme si soba elektrike, me gaz, ose me furnizim tjetër.

Pyetja 4.2 *(mund të jepet më shumë se 1 përgjigje)*

• Shënoni cila është lënda djegëse ose energjia që ushqen impiantin e ngrohjes duke iu referuar periudhës në të cilën impianti i ngrohjes është në punë. Në qoftë se banesa ngrohet me anë të telengrohjes ose të pompave të ngrohjes, shënoni me kryq kutinë 9.

5. Punime/ndërhyrje në impiantet e në elementet strukturore të banesës

Rubrika ka të bëjë me ndërhyrjet e mirëmbajtjes, restaurimet, përmirësimet, ristrukturimet e të tjera si këto, të bëra banesës në 10 vitet e fundit nga kush ka banuar aty në këtë periudhë kohore ose që banon aktualisht. Nuk duhen marrë parasysh punimet e vogla dhe as ndërhyrjet e kryera në ndërtesën ku banesa gjendet.

Pyetja 5.1

• Me punime dhe/ose ndërhyrje në impiante kuptohen ato të kryera për të mbajtur në efiçencë impiantet (e ujit, sanitar, të ngrohjes, elektrik, etj.) për t'i ripërtërirë, për t'i ndryshuar, e të tjera si këto. Riparimet e vogla nuk duhet konsideruar.

Pyetja 5.2

• Me punime dhe/ose ndërhyrje në elementet strukturore kuptohen ato të përforcimit e të restaurimit ose të përtëritjes të strukturave vertikale, zëvendësimi i ndërkateve e të tjera si këto, zgjerime ose zvogëlime të hapësirave, etj.

• Në rast përgjigjeje pohuese pyetjes 5.2, shënoni (në pyetjen 5.3) edhe vitin në të cilin janë kryer punimet. Në rast se punimet janë në vazhdim e sipër, shënoni "2001"

Pyetja 5.4

• Me punime dhe/ose ndërhyrje në elementet jo strukturore kuptohen ato si zëvendësimi tërësor ose i pjesshëm i dyshemeve, ribërja e suvasë, zëvendësimi i mureve të brendshme ndarëse, e të tjera si këto.

6. Vendi për automjet

Pyetja 6.1, 6.2, 6.3

Shënoni në rast se personat që banojnë në banesë kanë të disponueshëm të paktën një vend për automjet, personal e të garantuar, në brendësi të ndërtesës në të cilën banojnë ose në afërsi të saj. Me **disponueshmëri** kuptohet që përdorimi i vendit për automjet është i garantuar (në çfarëdolloj momenti) sepse është në pronësi, i marrë me qira, ose i dhënë gratis.

• Me **garazh privat** kuptohet një dhomë e mbyllur, e përshtatshme për vendosjen e një automjeti, dhe i përdorur për këtë qëllim.

• Me **vend të mbyllur për automjet** kuptohet ai për përdorim personal dhe të rezervuar, i vendosur në një dhomë të mbyllur e përshtatur për vënien e shumë automjeteve, dhe i përdorur për këtë qëllim. Për shembull garazhet e bashkëpronarëve të vendosura poshtë ndërtesës, garazhet e vendosura në ndërtesa të ndërtuara posaçërisht, garazhet kolektive të ruajtura, e të tjera si këto.

• Me **vend të hapur për automjet** kuptohet ai, personal dhe i rezervuar, i vendosur në një hapësirë jashtë; për shembull brenda oborreve, poshtë një kati *pilotis* të një ndërtese, në katin e fundit të zbuluar të një ndërtese e ndërtuar për të qenë vend parkimi, e të tjera si këto.

SEKSIONI II – TË DHËNA PËR PERSONAT QË KANË VENDBANIM TË ZAKONSHËM NË BANESË

1. Të dhëna për gjendjen civile

Pyetja 1.1

• Nuk i përgjigjet kësaj pyetjeje ai që kryeson ne Fletën e familjes ose personi që i referohet (personi 1 i Listës A)

• Fëmijët duhen klasifikuar si të tillë në rast se janë të pranuar nga personi që kryeson dhe/ose nga bashkëshorti ose bashkëjetuesi.

• Fëmijët vetëm të bashkëshortit ose të bashkëjetuesit të personit që kryeson duhet të shënojnë me kryq kutine 06 ("Bir/Bijë vetëm të bashkëshortit/bashkëjetuesit"), edhe pse prindi ka vdekur ose nuk banon zakonisht në banesë. Të afërmit e tjerë vetëm të bashkëshortit ose të bashkëjetuesit të personit që ka emrin në krye duhet të shënojnë me kryq kutine që ka të bëjë me marrëdhëniet përkatëse të farefisnisë, edhe pse bashkëshorti/bashkëjetuesi i atij që kryeson ne fleten e familjes nuk banon zakonisht në banesë.

• Duhet të shënojë me kryq kutinë 08 (Vjehërr i/e personit që kryeson në fletën e familjes") edhe prindi (ose bashkëshorti i prindit) i bashkëjetuesit i personit që kryeson në fletën e familjes.

• Të afërmit e atij që kryeson në fletën ose të bashkëshortit ose të bashkëjetuesit të papërmendur në përgjigje (xhaxhai i personit që ka emrin në krye të fletës ose i bashkëshortit ose i bashkëjetuesit, gjyshi i personit që kryeson në fletën ose i bashkëshortit ose i bashkëjetuesit, kushuriri i personit që kryeson në fletën ose i bashkëshortit ose i bashkëjetuesit, etj.), që banojnë zakonisht në këtë banesë, duhet të shënojnë me kryq kutinë 15 ("I afërm tjetër i personit që kryeson në fletën e familjes ose i bashkëshortit ose i bashkëjetuesit").

• Personat që banojnë zakonisht në këtë banesë e nuk kanë lidhje farefisnore me atë që kryeson ne fletën e familjes ose me bashkëshortin ose me bashkëjetuesin, duhet të shënojnë me kryq kutinë 16 ("Tjetër person bashkëjetues"). Në rast se përbëjnë familje të veçantë, duhet të përpilojnë një Fletë familje tjetër.

• Personeli i shërbimit të familjes (shërbyes, bashkëpunëtor familjar) që banon zakonisht në banesë, në rast se përbën familje më vete, duhet të përpilojë një Fletë familje tjetër.

Pyetja 1.3

• Data e lindjes duhet shkruar me shifra e jo me shkronja. Për shembull: 06/02/1954.

Pyetja 1.4

• Për ata që janë lindur në një komunë tjetër italiane duhet shënuar emri aktual i komunës ku personi është lindur. Shënoni emrin e komunës e jo të lokalitetit (fraksion, qendër e banuar, etj.).

• Për ata që janë lindur jashtë shtetit duhet shënuar emri aktual i shtetit të huaj brenda kufijve të tanishëm të të cilit gjendet vendi i lindjes.

• Shteti i huaj i lindjes duhet shënuar me shkronja latine dhe në italisht.

2. Shtetësia

Pyetja 2.1

• Shtetasit e huaj duhet të shënojnë me kryq kutinë 2 dhe të cilësojnë emrin e shtetit të huaj që i takon shtetësisë me shkronja latine e në italisht.

• Shtetasit e huaj me më shumë shtetësi (përveç asaj italiane) duhet të saktësojnë vetëm një shtet të huaj të shtetësisë, sipas dëshirës.

• Personat që nuk kanë asnjë shtetësi duhet të deklarohen pa shtetësi (duke shënuar me kryq kutinë 3). Në kategorinë e atyre pa shtetësi futen edhe personat gjendja e shtetësisë së të cilëve nuk është sqaruar ende pas shpërbërjes, ndarjes ose bashkimit të Shteteve.

Pyetja 2.2

• Kush është shtetas italian që kur ka lindur duhet të shënojë me kryq kutinë 1 ("Që nga lindja"), edhe në rast se është lindur jashtë shtetit. Bëhet e ditur se është shtetas italian që nga lindja:

a) ai që ka të paktën një prind me shtetësi italiane;
b) ai që është lindur në Itali në qoftë se të dy prindërit janë të panjohur ose pa shtetësi, ose në qoftë se fëmija nuk ndjek shtetësinë e prindërve sipas ligjit të Shtetit të cilit ata u përkasin;
c) fëmija i të panjohurve i gjetur në Itali, në rast se nuk provohet posedimi i shtetësie tjetër.

• Ai që është bërë qytetar italian pas një kërkese të posaçme dhe një akti vijues dhënie nga ana e autoriteteve kompetente duhet të shënojë me kryq kutinë 2 (Marrë p.sh. për martesë, naturalizim"). Duhet të shënojë me kryq kutinë 2 edhe ai që është bërë shtetas italian për marrje "automatike" të shtetësisë. Për shembull, duhet të shënojë me kryq kutinë 2:

a) i mituri që ka marrë shtetësinë italiane sepse është birësuar nga një shtetas italian ose për njohje amësie ose atësie (ose deklaratë gjyqësore e njohjes së bijësisë) nga ana e prindit italian;
b) fëmija e mitur që bashkëjeton me atë që ka marrë shtetësinë italiane;
c) ai që ka marrë shtetësinë italiane për arsye martese, naturalizimi të zakonshëm ose të jashtëzakonshëm, për arsye lindje në Itali dhe rezidence legale të pandërprerë deri në moshën 18 vjeçare.

• Ai që shënon me kryq kutinë 2 duhet të tregojë shtetin e huaj të shtetësisë së mëparshme, me shkronja latine dhe në italisht.

Pyetja 2.3

• Shënoni vitin e transferimit të vendbanimit të zakonshëm në Itali.

Pyetja 2.4

Shënoni arsyen e transferimit të vendbanimit të zakonshëm në Itali (edhe në qoftë se e ndryshme nga arsyeja aktuale e qëndrimit).

• Duhet të shënojnë me kryq kutinë 1 ("Punë") ata që kanë ardhur në Itali për të punuar, edhe nëse janë ende pa punë.

• Duhet të shënojnë me kryq kutinë 2 edhe ai që pasi ka ardhur në Itali për të ndjekur një kurs studimesh, ka mbetur për të punuar pasi ka përfunduar studimet.

• Duhet të shënojnë me kryq kutinë 3 ("Prani familjarësh") vetëm ata që kanë ardhur në Itali për t'u bashkuar me familjarët. Ky katror nuk duhet shënuar nga ata që kanë ardhur në kërkim të një pune dhe që kanë zgjedhur Italinë sepse aty gjendej një kushëri me mundësi për ta ndihmuar.

3. Gjendja civile dhe martesa

Pyetja 3.1

• Personat e martuar që nuk jetojnë më me bashkëshortin për shkak të një gjendje krize të çiftit duhet të shënojnë me kryq kutinë 3 ("I/e ndarë faktikisht") e jo kutinë 2 ("I/e martuar").

• Personat e martuar që jetojnë larg nga bashkëshorti për arsye rastësore ose nevoje duhet të shënojnë me kryq kutinë 2 ("I/e martuar") e jo kutinë 3 (I/e ndarë faktikisht").

• Personat "të martuar dikur" (ose personat që kanë arritur zgjidhjen ose përfundimin e efekteve civile të martesës sipas ligjit të 1 dhjetorit 1970, nr. 898) duhet të shënojnë me kryq kutinë 5 ("I/e zgjidhur nga martesa").

Pyetja 3.2

Përveç të martuarve duhet të përgjigjen edhe personat e ndarë faktikisht ose ligjërisht, të zgjidhur nga martesa, e ve.

Data e celebrimit të martesës duhet të shënohet me shifra e jo me shkronja (në rast të disa martesave, shënoni datën e martesës së fundit).

4. Prania e vendbanimi

Pyetja 4.1

• Shënoni me kryq kutinë që i përket vendit në të cilin personi është i pranishëm në datën e Regjistrimit (21 tetor 2001).

• Shënoni me kryq kutinë 1 ("Në këtë banesë") ose 2 ("Në këtë komunë, por në një banesë tjetër ose vend bashkëjetese") edhe nëse personi mungonte nga komuna më 21 tetor 2001 por ka ardhur përsëri më 22 tetor 2001 e nuk është regjistruar diku tjetër.

Pyetja 4.2

• Duhet të shënojë me kryq kutinë 1 ("Po") në qoftë se në dymbëdhjetë muajt e fundit personi ka munguar nga kjo banesë, **me ndërprerje** (duke u kthyer aty çdo javë, çdo muaj, etj.) ose **për një periudhë të caktuar kohe**, duke jetuar në banesa të tjera ose në vende bashkëjetese (p.sh. shtëpi kushërinjsh ose miqsh, pension, shtëpi studenti, hotel, kazermë, klinikë, spital). Për shembull, duhet shënuar me kryq kutia 1 ("Po") në qoftë se në dymbëdhjetë muajt e fundit personi ka munguar nga kjo banesë për një nga arsyet e mëposhtme:

a) për të shkuar në komunën ku zhvillon veprimtarinë e vet profesionale;
b) për të shkuar në komunën ku frekuenton universitetin;
c) sepse i shtruar në institut kurimi;
d) për të shkuar në një komunë tjetër ku disponon një banesë të dytë ose ku zotëron pasuri të patundshme për ta administruar ose ku ka interesa për t'i mbrojtur.

Pyetja 4.3

• Ai që ka munguar nga banesa duke u kthyer aty herë pas here duhet të tregojë **totalin** e ditëve të mungesës (duhet pra të marrë parasysh tërësinë e periudhave të mungesës në dymbëdhjetë muajt e fundit).

Pyetja 4.7

• Ai që një vit më parë kishte vendbanim të zakonshëm në një komunë tjetër italiane duhet të shënojë emrin aktual të komunës ku kishte vend banimin. Shënoni emrin e komunës e jo emrin e lokalitetit (fraksion, qendër e banuar, etj.).

• Ai që një vit më parë kishte vendbanim të zakonshëm jashtë shtetit duhet të shënojë emrin aktual të shtetit të huaj (me shkronja latine e në italisht) brenda kufijve aktualë të të cilit gjendej vendi i banimit të zakonshëm.

5. Titulli i studimit dhe kualifikimi

Pyetja 5.1

• Për fëmijët që frekuentojnë çerdhen ose kopshtin (për të cilët është shënuar katrori 1 ose katrori 2), shkoni në pikën 8.

• Për fëmijët që janë më pak se 6 vjeç e që nuk frekuentojnë as çerdhen as kopshtin, por që frekuentojnë klasën e parë të shkollës fillore (për shembull fëmijët e lindur midis 22 tetorit e 31 dhjetorit 1995, përgjigjuni pyetjes 5.2 (duke shënuar me kryq katrorin 02).

• Për fëmijët që janë më pak se 6 vjeç e që nuk frekuentojnë as çerdhen as kopshtin dhe as klasën e parë të shkollës fillore, përfundon këtu përpilimi i pyetësorit.

Pyetjet 5.2 e 5.3

• Pyetjes 5.2 duhet t'i përgjigjen personat 6 vjeç ose më tepër e fëmijët që janë më pak se 6 vjeç që frekuentojnë klasën e parë të shkollës fillore (për shembull fëmijët e lindur midis 22 tetorit e 31 dhjetorit 1995).

• Duhet t'i japin përgjigje pyetjes 5.3 vetëm ata që në pyetjen 5.2 kanë shënuar një nga kutite e përfshirë midis 09 dhe 11.

Me titull studimi kuptohet një titull të cilit Shteti i jep një vlerë ligjore, i marrë në fund të një kursi arsimimi.

Për t'u përgjigjur në mënyrë të përshtatshme pyetjeve 5.2 e 5.3 është e nevojshme t'u përmbaheni udhëzimeve të mëposhtme.

• Personat që kanë dy ose më shumë tituj studimi të të njëjtës gradë duhet të tregojnë vetëm një e saktësisht atë që konsiderohet më i rëndësishëm në lidhje me një veprimtari eventuale profesionale të ushtruar.

• Nxënësit e klasës së parë të shkollës fillore duhet të shënojnë me kryq kutine 02.

• Personat që kanë çertifikatën e klasës së tretë fillore duhet të shënojnë: kutine 01 në qoftë se nuk dinë të lexojnë ose të shkruajnë ("Asnjë titull studimi dhe nuk di të lexojë ose të shkruajë"); kutine 02 në qoftë se dinë të lexojnë e të shkruajnë ("Asnjë titull studimi por di të lexojë e të shkruajë").

• Personat që kanë një çertifikatë të lëshuar pas një kursi në shkollë popullore e tipit C duhet të shënojnë kutine 03 ("Dëftesë e shkollës fillore").

• Personat (në veçanti **shtetasit e huaj**) që kanë ndjekur **jashtë shtetit** titullin e studimit më të lartë duhet të shënojnë kutine e titullit përkatës në Itali.

• Shtetasit e huaj që nuk kanë marrë asnjë titull studimi duhet të zgjedhin midis modaliteteve 01 ("Asnjë titull studimi dhe nuk di të lexojë ose të shkruajë") dhe 02 ("Asnjë titull studimi por di të lexojë e të shkruajë") **duke iu referuar gjuhës së vet amtare**.

PËRKUFIZIME

Dëftesa e shkollës fillore: përkon me përfundimin e nivelit të parë të arsimit bazë.

Dëftesa e shkolles se mesme të ulët (qe i korespondon ciklit të dytë të shkollës tetëvjeçare): përkon me përfundimin e nivelit të dytë të arsimit bazë. Për pranimin në kurse kërkohet dëftesa e shkollës fillore.

Diploma e shkollës së mesme të lartë e marrë pranë **Liceut Klasik, Shkencor, Gjuhësor o Artistik:** merret në fund të një cikli studimesh prej 4 ose 5 vitesh dhe lejon regjistrimin në një kurs studimesh universitare. Për pranimin në kurse kërkohet dëftesa e shkollës së mesme të ulët. Personat që kanë marrë si titull studimi më të lartë Diplomën e pjekurisë (ose provim Shteti) pranë Liceut Klasik, Shkencor, Gjuhësor ose Artistik, në pyetjen 5.2 duhet të shënojnë një nga kutite të përfshirë midis 05 dhe 08.

Diploma e shkollës së mesme marrë pranë **Institutit Profesional, Shkollës Pedagogjike, Institutit të Artit, Institutit Teknik ose Institutit Pedagogjik.** Dallohet në:

a) titull Instituti Pedagogjik, Instituti Profesional, Instituti Arti ose diplomë Shkolle Pedagogjike: titull studimi i marrë në fund të një cikli studimesh të mesme më pak se 4 vjet (kurs 2-3 vjetësh), që nuk lejon regjistrimin në një kurs studimesh universitare. Për pranimin në kurse kërkohet dëftesa e shkollës së mesme të ulët. Personat që kanë marrë si titull studimi më të lartë titullin e Institutit Profesional, të Institutit të Artit, ose diplomën e Shkollës Pedagogjike duhet të shënojnë tek pyetja 5.2 një nga kutine e përfshirë midis 09 e 11 dhe pyetjes 5.3 kutine 1;

b) diplomë pjekurie (ose provim i shtetit): titull studimi i marrë në fund të një cikli studimesh të mesme prej 4-5 vjetësh, që lejon regjistrimin në një kurs studimesh universitare. Për pranimin në kurse kërkohet diploma e shkollës së mesme të ulët. Personat që kanë marrë si titull studimi më të lartë diplomën e pjekurisë (ose provimin e shtetit) pranë Institutit Profesional ose Shkollës Pedagogjike ose Institutit të Artit ose Institutit Teknik ose Institutit Pedagogjik duhet të shënojnë tek pyetja 5.2 një nga kutite të përfshirë midis 09 e 13. Në qoftë se diploma e pjekurisë (ose provimi i shtetit) është marrë pranë Institutit Profesional ose Shkollës Pedagogjike ose Institutit të Artit te pyetja 5.3 shënoni me kryq kutine 2.

Diploma jo universitare pas diplomës së pjekurisë: titull studimi i marrë në fund të një kursi studimesh jo universitare pranë Akademisë së Arteve të Bukura, Institutit të Lartë të Industrisë Artistike, Akademisë Kombëtare e Artit Dramatik, Akademisë Kombëtare të Baletit (diplomë perfeksionimi – kurs prej 3 vjetësh), Konservatorit të Muzikës ose Institutit të Muzikës i njohur zyrtarisht (diplomë perfeksionimi – kurs prej 2-3 vjetësh), Shkollës së Mesme për Përkthyes ose Shkollës për arkivistë, Shkollës së Paleografisë dhe Diplomatike. Kohëzgjatja ndryshon sipas kursit të parazgjedhur. Për t'u futur në këto kurse është e nevojshme të keni diplomën e shkollës së mesme të lartë (kurs prej 4-5 vjetësh). Përjashtohen kurse të kualifikimit profesional pas diplomës së pjekurisë.

Diploma Universitare (Shkolla me qëllime të posaçme ose parauniversitare, Diploma e shkurtër): titull studimi i dhënë në fund të një kursi diplome universitare e nga shkollat me qëllime të posaçme. Merret pas një kurs studimesh me kohëzgjatje jo më pak se 2 vjet e jo më shumë se 3 (diplomë në statistikë, në mbikëqyrje në shkollat fillore, diploma ISEF, diploma në paleografi e filologji muzikore, etj.). Diploma universitare ose diploma e shkurtër, në nivel ndërkombëtar, i përket gradës së parë të ciklit të parë të arsimit universitar (p. sh. *bachelor's degree* - ose *first degree* – në anglisht). Për t'u futur në këto kurse është e nevojshme të keni diplomën e shkollës së mesme të lartë (kurs prej 4-5 vjetësh).

Diploma: titull studimi që merret pas një kursi studimesh universitare me kohëzgjatje jo më pak se 4 vjet e jo më shumë se 6. Kursi i diplomës ka qëllimin t'u japë studentëve njohuri të përshtatshme metodash e përmbajtjesh kulturore, shkencore e profesionale të nivelit të lartë. Për t'u futur në këto kurse është e nevojshme të keni diplomën e shkollës së mesme të lartë (kurs prej 4-5 vjetësh). Diploma, në nivel ndërkombëtar, përkon me shkallën e dytë të ciklit të parë të arsimit universitar (p.sh. *maitrise* franceze).

Pyetja 5.5

• **Diploma (ose dëshmia) e Specializimit** merret pas diplomës, në fund të një kursi studimesh me kohëzgjatje jo më pak se 2 vjet që synon të formojë specialistë në sektorë profesionalë të caktuar, pranë shkollave të specializimit.

• **Doktorata** merret pas diplomës, në fund të një kursi studimesh e hulumtimi personal me kohëzgjatje jo më pak se 3 vjet që synon të thellojë kërkimin shkencor e metodologjinë e studimit në sektorin përkatës.

• Në nivel ndërkombëtar **diploma e specializimit** e **doktorata** janë tituj studimi pas diplome që janë të barazvlershëm me përfundimin e ciklit të dytë të arsimit universitar (p. sh. *Ph.D*).

• **Duhet të shënojnë me kryq katrorin 1 edhe personat që kanë një "Diplomë speciale"** (diploma e dytë pas përfundimit të studimeve) domethënë e marrë pas një kursi me kohëzgjatje të paktën prej 4 vjetësh pas diplomës (p.sh. Inxhinjeri Kozmike).

Pyetja 5.7

• Për shembull, për të marrë *bachelor's degree* amerikane ose angleze janë të nevojshme në përgjithësi 16 vjet shkollë; për të marrë *master's degree* angleze 17, ndërsa për *master's degree* amerikane janë të nevojshme 17 ose 18 vjet shkollë.

Pyetja 5.8

Pyetjes 5.8 duhet t' përgjigjen personat që janë 6 vjeç e lart dhe fëmijët më të vegjël se 6 vjeç që frekuentojnë klasën e parë të shkollës fillore (për shembull fëmijët e lindur midis 22 tetorit e 31 dhjetorit 1995).

• **Shkolla e mesme e larte** përfshin Institutet/Shkollat/Licetë pranë të cilave mund të merret diploma shkollore e titullit profesional, artistik, pedagogjik ose diploma e pjekurisë (ose provimi i shtetit).

• **Regjistrimi në universitet** mund t'i referohet një kursi për marrjen e diplomës universitare, një kursi për marrjen e diplomës, një kursi për marrjen e specializimit pas diplome, një kursi për marrjen e doktoratës ose një kursi perfeksionimi. (Përfshihen edhe shkollat me qëllime speciale).

• **Kurset jo universitare pas diplomës së pjekurisë** përfshijnë Kurset pranë Akademisë së Arteve të Bukura, Institutit të Lartë të Industrisë Artistike, Akademisë Kombëtare të Artit Dramatik, Akademisë Kombëtare të Baletit (diplomë perfeksionimi – kurs prej 3 vjetësh), Konservatorit të Muzikës ose Institutit të Muzikës të njohur zyrtarisht (diplomë perfeksionimi – kurs prej 2-3 vjetësh), Shkollës së Mesme për Përkthyes, Shkollës për arkivistë, Shkollës së Paleografisë dhe asaj Diplomatike.

Pyetja 5.10

• Ne kurset e kualifikimit ose specializimit/azhurnimit profesional të organizuar dhe/ose të financuar nga ndërmarrja, enti, administrata ku punohet futen, për shembull, kurset e gjuhëve të huaja, e informatikës bazë, kurset që kanë si objektiv përdorimin e aparaturave.

• Ne kurset e kualifikimit ose specializimit profesional krahinor, provincial, etj., futen për shembull kurset për programator, parukier, estetist, pastiçer, argjendar, kurset për asistentët e personave handikap.

• Ne kurset e kualifikimit profesional privat futen, për shembull, kurset e gjuhëve të huaja, të informatikës, daktilografisë, stenografisë, e përjashtohen kurset e llojit argëtues.

6. Gjendja profesionale ose jo profesionale

Pyetja 6.1

Për t'iu përgjigjur në mënyrë të duhur pyetjes, përmbajuni përkufizimeve të mëposhtme:

I punësuar:

• ai që është i vetëpunësuar ose i marrë në punë nga e cila nxjerr një fitim ose një rrogë (duhen konsideruar çdo lloj të ardhurash: pagesë, rrogë, honorar, fitim, pagim i shpenzimeve, pagesa eventuale në natyrë, ushqim e fjetje);

• ai që bashkëpunon me një familjar që zhvillon veprimtari pune për llogari të vet pa patur një kontratë të rregullt pune ose një rrogë (ndihmës familjar).

Çdo lloj forme pune jo tipike, me ose pa kontratë, përbën një kusht të mjaftueshëm për t'u futur midis atyre me punë, mjaft që orët e punës të kryera të kënë një kundërvlerë në para ose në natyrë. Duhet të konsiderohen të punësuar edhe:

a) personat që në javën para datës së regjistrimit nuk kanë bërë orë pune për arsye leje, sëmundje, leje lindjeje, *part time*, pa të drejtë page, me pagese për punen e munguar, për mungesë porosish, etj.;
b) personat që zhvillojnë një veprimtari pune në cilësinë e nxënësit, praktikantit të paguar;
c) personat e punësuar me kontratë pune me kohë të caktuar;
d) personat që zhvillojnë stazhe të paguara.

Nuk duhet të konsiderohet i punësuar (prandaj nuk duhet të shënojë kutinë 01):

• ai që frekuenton një kurs universitar për marrjen e doktoratës, mjekët që frekuentojnë shkollën e specializimit, titullarët e bursave të studimit e personat që zhvillojnë një aktivitet vullnetar shoqëror <u>të pashpërblyer</u>;

• ai që mbaron shërbimin ushtarak ose që po zhvillon shërbimin civil, pavarësisht nga gjendja e mëparshme ose e ardhshme e punës, pra edhe nëse personi ka një punë me të drejtën e ruajtjes së vendit të punës ose në qoftë se është në kërkim të një pune.

Në kërkim të punës së parë: ai që,

a) pasi ka mbaruar, ndërprerë, braktisur një cikël studimesh;
b) meqënëse nuk ka ushtruar kurrë një veprimtari pune ose ka ndërprerë një veprimtari të vetën;
c) pasi ka ndërprerë "në mënyrë të vullnetshme" së punuari për një farë periudhe kohe (të paktën 1 vit);

është në kërkim aktiv të një pune dhe është në gjendje ta pranojë nëse i ofrohet.

I papunë në kërkim të një pune të re: ai që, pasi ka humbur një punë të mëparshme nga punëdhënesi, është në kërkim aktiv të një pune dhe është në gjendje ta pranojë nëse i ofrohet.

Në pritje për të filluar një punë që ka gjetur prej kohe: ai që, pasi ka gjetur prej kohe një punë tek nje punedhenes, ose ai që pasi ka përgatitur të gjitha mjetet për ushtrimin e një veprimtarie më vete, do të fillojë të punojë javët e mëpasshme.

Student: ai që i kushtohet kryesisht studimit.

Shtëpiak/e: ai që i kushtohet kryesisht përkujdesjeve të familjes së vet e të shtëpisë së vet.

I dalë nga puna: ai që ka ndërprerë një veprimtari pune për arsye se ka arritur kufijtë e moshës, për arsye invaliditeti ose shkak tjetër. Figura e të dalit nga puna nuk përkon domosdoshmërisht me atë të pensionistit pasi jo gjithnjë ai që ka dalë nga puna gëzon një pension.

Në shërbim ushtarak ose në shërbim civil zëvendësues: futen në këtë kategori të gjithë personat që, duke iu referuar javës para datës së Regjistrimit (nga 14 deri 20 tetor 2001), po zhvillojnë shërbimin ushtarak ose shërbimin civil zëvendësues pavarësisht nga gjendja e mëparshme ose e ardhshme e punës, qoftë në rastin kur kanë një punë me të drejtën e ruajtjes së vendit të punës qoftë në rastin kur janë në kërkim të një pune.

I paaftë për punë: ai që ka një sëmundje fizike ose mendore të tillë që e bën të pamundur zhvillimin e një veprimtarie pune.

Në gjendje tjetër: ai që ka gjendje tjetër të ndryshme nga ato të radhitura më lart (për shembull i pasur, në pension për arsye të ndryshme nga veprimtaria e punës – titullar i pensionit shoqëror, pension invaliditeti).

Pyetja 6.2

Me punë kuptohet çdo lloj veprimtarie që synon marrjen e një shpërblimi, page, rroge, fitimi, etj.

Duhet të shënojnë me kryq kutinë 1 ata që:

• në javën para datës së Regjistrimit (nga 14-20 tetor 2001) kanë zhvilluar një ose më shumë orë pune të paguara, tek punëdhënësi ose në mënyrë autonome, duke zhvilluar një veprimtari të llojit të zakonshëm, të rastit ose stinor pavarësisht nga vazhdimësia e nga ekzistenca e një kontrate të rregullt pune. Duhet konsideruar çdo lloj të ardhure: shpërblim, rrogë, fitim, pagim shpenzimesh, pagesa eventuale në natyrë, ushqim, fjetje ose tjetër, edhe në qoftë se nuk është marrë ende ose marrë në një javë të ndryshme nga ajo kur është kryer puna;

• në javën para datës së Regjistrimit (nga 14 deri më 20 tetor 2001) kanë zhvilluar një ose më shumë orë pune duke ndihmuar një familjar ose një kushëri në veprimtarinë e tij autonome, ndërmarrje, edhe pa qenë të paguar (ndihmës familjar).

Për **ndihmës familjar** kuptohet ai që bashkëpunon me një familjar që zhvillon një veprimtari për llogari të vet, pa patur një marrëdhënie pune të rregulluar nga një kontratë (për shembull gruaja që ndihmon burrin në dyqan, biri që ndihmon të jatin bujk).

Duhet të shënojnë kutinë 2:

• ata që në javën para datës së Regjistrimit (nga 14 deri 20 tetor 2001) kanë zhvilluar orë pune të pa shpërblyera pranë organizmave, instituteve, shoqatave e të tjera si këto në cilësinë e pjesëmarrësit vullnetar në veprimtaritë e tyre;

• punonjësit stinorë që nuk kanë bërë orë pune në javën që i referohet.

Nuk duhet të konsiderohen gjithashtu orët e kushtuara për punët e shtëpisë, mirëmbajtje të vogla ose riparime në shtëpi, hobbies, e të tjera si këto.

Pyetja 6.3

• Duhet të shënojnë me kryq katrorin 1 ("Po") ata që në 4 javët e fundit (nga 21 shtatori deri në 20 tetor 2001) u janë përgjigjur ofertave të punës

të botuara në gazeta të përditshme, kanë paraqitur kërkesë në një konkurs, kanë dërguar *curriculum*-in e vet një ndërmarrjeje, etj.

Pyetja 6.5

• Duhet konsideruar çdo lloj veprimtarie, pranë një punëdhënësi ose në mënyrë autonome, të llojit të zakonshëm, të rastit ose stinor pavarësisht nga vazhdimësia ose nga ekzistenca e një kontrate të rregullt pune. Orët e punës të bëra duhet të jenë shpërblyer. Duhen konsideruar çdo lloj të ardhurash: pagesë, rrogë, fitim, pagim i shpenzimeve, pagesa eventuale në natyrë, ushqim, fjetje o tjetër. Duhet të konsiderohen edhe veprimtaritë e punës që zhvillohen në cilësinë e ndihmësit familjar.

7. Veprimtari pune

• Përgjigjuni nga pyetja 7.1 në pyetjen 7.12 duke iu referuar veprimtarisë së punës kryesore të zhvilluar në javën para datës së Regjistrimit (nga 14 deri më 20 tetor 2001).

• Me veprimtari pune kryesore kuptohet ajo së cilës i kushtohet numri më i madh të orëve të punës.

• Personat e punësuar që në javën para datës së Regjistrimit (nga 14 deri më 20 tetor 2001) nuk kanë bërë orë pune për arsye leje, sëmundje, pune te munguar, pa te drejte page, etj., duhet t'i referohen veprimtarisë kryesore së punës që zhvillohet zakonisht.

• Personat që në javën para datës së Regjistrimit (nga 14 deri më 20 tetor 2001) kanë ndryshuar veprimtari pune duhet t'i referohen veprimtarisë së re të kryer në fund të asaj jave.

Pyetja 7.2

• Në rastin e modalitetit "Leje lindjeje" (kutia 3) futen edhe mungesat e baballarëve, siç parashikohet nga ligjet në fuqi në fushën e "lejes prindërore".

• Në rastin e modalitetit "Tjetër" (kutia 7) futet për shembull kontrata *part time* vertikale që parashikon mungesën nga vendi i punës në disa ditë, javë ose muaj të vitit.

Pyetja 7.3

• Duhet shënuar numri i orëve efektivisht të kryera në javën para datës së Regjistrimit (nga 14 deri më 20 tetor 2001) pavarësisht nga sa parashikohet nga marrëdhënia e punës (sipas kontratës, marrëveshjes, etj.) për vartësit e nga orari normal e i zakonshëm i veprimtarisë për punën autonome.

• Duhen **përfshirë** orët jashtë orarit, si të paguarat ashtu edhe ato të pa paguara.

• Duhen **përjashtuar** orët për vajtjen nga banesa te vendi i punës dhe ato që shërbejnë për vaktin kryesor të ngrënies gjatë pushimit në punë.

• Personat që ndjekin kurse kualifikimi profesional, përfshirë nxënësit e praktikantët, duhet të përjashtojnë orët e ndjekjes së shkollës ose të qendrës së kualifikimi nëse janë jashtë ndërmarrjes.

• Për personat që mungojnë për arsye pune ose biznesi dhe për anëtarët e ekuipazhit në lundrim duhet të shënohen, në kujdesin e një anëtari tjetër të familjes, orët efektivisht (ose të supozueshme) të kryera.

Pyetja 7.4

• ***Part time***: marrëdhënie pune, me ose pa kontratë, që parashikon një numër orësh pune më të vogël se ai normalisht në fuqi për të punësuarit e tjerë të së njëjtës kategori. Mund të jetë e tipit:

a) horizontal: kur puna zhvillohet në të gjitha ditët por me orar të reduktuar;

b) vertikal: kur puna përqëndrohet vetëm në disa ditë të javës, ose në disa javë, ose në disa muaj të vitit.

• Për punonjësit vartës *part time* caktohet në bazë të një marrëveshje formale midis punëdhënësit e punonjësit.

• Edhe një punonjës autonom mund të punojë me orar të pjesshëm (për shembull, dyqanxhiu që e zhvillon veprimtarinë e vet në dyqanin e tij vetëm në mëngjes ose pasdite punon *part time*).

Pyetja 7.5

I marre ne pune: ai që punon, me ose pa kontratë, për një punëdhënës publik ose privat e merr në formën e rrogës, pagës, pagesës së shpenzimeve, në natyrë, ushqim, fjetje, etj.

Imprenditor: ai që administron më vete një ndërmarrje (bujqësore, industriale, tregtare, shërbimesh, etj.) në të cilën punëson personel.

Profesionist i lirë: ai që ushtron për llogari të vet një profesion ose një zanat të lirë (noter, avokat, mjek, dentist, inxhinjer ndërtimi, etj.).

Punonjës më vete (I vetëpunësuar): ai që administron një ndërmarrje bujqësore, një ndërmarrje të vogël industriale ose tregtare, një punishte artizanale, një dyqan ose një shërbim publik, duke marrë pjesë me punën e vet të krahut. Futen në këtë kategori edhe kultivuesit e drejtpërdrejtë, gjysmatarët e të tjerë si këta, ai që punon në banesën e vet drejtpërsëdrejti për llogari të konsumatorëve e jo sipas porosive të ndërmarrjeve.

Ortak i një kooperative prodhimi të mirash dhe/ose shërbimesh: ai që është anëtar aktiv i një kooperative prodhimi të mirash dhe/ose shërbimesh, pavarësisht nga lloji i veprimtarisë në të cilën kooperativa vepron, domethënë ai që, si përkatësi tëi punës së bërë, nuk merr një shpërblim të rregulluar nga kontrata pune, por një shpërblim në përpjestim me punën dhe/ose kuotën e fitimeve të ndërmarrjes.

Ndihmës familjar: ai që bashkëpunon me një familjar që zhvillon një veprimtari për llogari të vet, pa patur një marrëdhënie pune të rregulluar nga një kontratë (për shembull gruaja që ndihmon burrin në dyqan, biri që ndihmon të atin bujk).

Pyetja 7.7

Marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar: i referohet një marrëdhënie pune që nuk ka afat ose një mbarim të paracaktuar.

Marrëdhënie pune me kohë të caktuar: i referohet një marrëdhënie pune që zgjidhet kur verifikohen kushte të caktuara objektive e të paracaktuara (për shembull, mbarimi i një afati, përfundimi i një detyre, arritja e një qëllimi, kthimi i vartësit përkohësisht i zëvendësuar).

Pyetja 7.8

Kontratë kualifikimi e pune: marrëdhënie pune e varur me kohë të caktuar me përmbajtje të përzier kualifikimi e pune, në të cilën punëdhënësi është i detyruar të kujdeset për kualifikimi profesional të individëve të punësuar. Kohëzgjatja e kontratës ndryshon nga 12 deri 36 muaj.

Kontratë për mësimin e profesionit: marrëdhënie pune me përmbajtje të përzier kualifikimi e pune, në të cilën punëdhënësi është i detyruar t'i transmetojë nxënësit njohjet e aftësitë teknike/të dorës të mjaftueshme për t'u bërë një punonjës i kualifikuar. Kontrata për mësimin e profesionit mund të ketë një kohëzgjatje minimale prej 18 muajsh e maksimale prej 4 vitesh (5 vitesh për sektorin e artizanatit).

Punë e përkohshme: kontratë me anë të cilës një ndërmarrje që furnizon punë të përkohshme vë një ose më shumë punonjës të punësuar nga ajo në dispozicion të një ndërmarrje që të përdorë punën për përmbushjen e kërkesave me karakter të përkohshëm. Është një marrëdhënie tripalëshe midis punonjësit, agjencisë së punës së përkohshme dhe ndërmarrjes përdorëse.

Në kategorinë "**Tjetër**" futen llojet e kontratës me kohë të caktuar jo të saktësuara në modalitetet e mësipërme si për shembull: punët shoqërisht të dobishme / punët me dobi publike, bursë pune, plan për futjen në profesion, stazhe ose praktikë të paguar, kualifikimi të shpërblyer, punë në shtëpi për llogari të ndërmarrjeve (me sistem shpërblimi me akord), punë e herëpashershme, punë e rastit (punëtorë krahu, punonjës me ditë, etj.), kontrata të tjera me kohë të caktuar (për shembull puna stinore, ish neni 23 D.P.R. 171/91).

Pyetja 7.9

Për tju përgjigjur në mënyrë të përshtatshme pyetjes, është e nevojshme tju përmbaheni përkufizimeve të mëposhtme.

Zhvillon një punë si punëtor ose një punë shërbimi jo të specializuar. U referohet të gjithë atyre veprimtarive të punës që kërkojnë kompetencë e përvojë të nevojshme për të kryer punime të thjeshta, në disa raste edhe me mundim të konsiderueshëm fizik. Për të ushtruar veprimtari të tilla nuk është përgjithësisht i nevojshëm asnjë titull studimi.

Është specialist i impianteve të palëvizshme për prodhim, i makinerive, i linjave të montimit ose drejton automjete. U referohet të gjithë atyre veprimtarive të punës që kërkojnë kompetencë e përvojë të nevojshme për të vënë në punë e për të kontrolluar impiante prodhimi, aparatura, linja montimi të automatizuara, për të drejtuar automjete, për të montuar produkte. Për të ushtruar veprimtari të tilla është

përgjithësisht i nevojshëm një nivel arsimi i barazvlershëm me shkollën e detyruar.

Zhvillon një veprimtari pune të kualifikuar. U referohet atyre veprimtarive të punës që kërkojnë kompetencë e përvojë të nevojshme për të kryer punë krahu të llojit të kualifikuar për të cilat është e nevojshme qoftë njohja e materialeve dhe e mjeteve për t'u përdorur në proçesin prodhues, qoftë njohja e fazave të vetë proçesit në lidhje me produktin përfundimtar. Duhen futur në këtë klasë punët që kanë të bëjnë me nxjerrjen e materialeve bruto, me ndërtimin e godinave e të strukturave të tjera dhe me prodhimin e të mirave edhe artizanale. Për të ushtruar veprimtari të tilla është përgjithësisht i nevojshëm një nivel arsimi i barazvlershëm me shkollën e detyruar.

Kultivon pemë dhe/ose rrit kafshë. U referohet atyre veprimtarive të punës që kërkojnë kompetencë e përvojë të nevojshme për të kultivuar pemë, rritur kafshë, për të shfrytëzuar produktet e pyllit dhe për peshkimin. Për të ushtruar veprimtari të tilla është përgjithësisht i nevojshëm një nivel arsimi i barazvlershëm me shkollën e detyruar.

Zhvillon një veprimtari shitjeje ndaj publikut ose shërbimi ndaj personave.

U referohet atyre veprimtarive të punës që kërkojnë njohje e përvojë të nevojshme për t'u ofruar shërbime personave, shërbime mbrojtjeje dhe shërbime që kanë të bëjnë me shitje të mirash në dyqane ose tregje. Duhen futur në këtë klasë punët që konsistojnë në dhënien e shërbimeve në fushën e turizmit, në dhënien e shërbimeve në dhomë në hotele, shërbimet në tryezë e të kuzhinës në restorante, në dhënien e kurave estetike, shërbime mbrojtjeje për individët e për pronat. Futen gjithashtu profesionet që merren me mbajtjen e ligjit e të rendit, me ekspozimin e shitjen e produkteve. Për të ushtruar veprimtari të tilla është përgjithësisht i nevojshëm një nivel arsimi i barazvlershëm me shkollën e detyruar.

Zhvillon një veprimtari nëpunësi të llojit jo teknik. U referohet atyre veprimtarive të punës që kërkojnë kompetencë e përvojë të nevojshme për të organizuar, arkivuar e përpunuar informacione. Duhet të futen në këtë klasë punët që përfshijnë përdorimin e përpunuesve të teksteve e aparaturave të tjera të zyrës, punët që konsistojnë në regjistrimin e përllogaritjen e të dhënave numerike, në dhënien publikut të informacioneve të zyrës, në kryerjen e veprimeve të arkës, në marrjen e takimeve. Për të ushtruar veprimtari të tilla është përgjithësisht i nevojshëm një nivel arsimi i barazvlershëm me shkollën e detyruar.

Zhvillon një veprimtari teknike, administrative, sportive ose artistike me kualifikim të mesëm. U referohet atyre veprimtarive të punës që kërkojnë vënien në jetë të njohjeve e përvojës të llojit teknik në fushën e shkencave fizike, natyrore, të jetës, shoqërore, ekonomiko-organizative dhe njerëzore. Duhen futur në këtë klasë veprimtaritë që konsistojnë në përgatitjen e zbatimin e punimeve me karakter teknik duke aplikuar koncepte, metoda e proçedura të disiplinave shkencore që u referohen. Për të ushtruar veprimtari të tilla është përgjithësisht i nevojshëm një nivel arsimi i barazvlershëm me shkollën e mesme (kurs prej 4-5 vjetësh).

Zhvillon një veprimtari organizative, teknike, intelektuale, shkencore ose artistike me specializim të lartë. U referohet atyre veprimtarive të punës që kërkojnë njohjen e përvojën profesionale në fushën e shkencave fizike, natyrore, të jetës, shoqërore, ekonomiko-organizative dhe njerëzore. Duhen futur në këtë klasë veprimtaritë që konsistojnë në aplikimin e koncepteve e teorive shkencore ose artistike për zgjidhjen e problemeve e në fushën e kualifikimit e të edukimit. Për të ushtruar veprimtari të tilla është përgjithësisht i nevojshëm një nivel arsimi i llojit universitar.

Administron një ndërmarrje ose drejton punën e disa strukturave të ndërlikuara. U referohet atyre veprimtarive të punës që përfshijnë drejtimin e koordinimin e veprimtarive të ndërmarrjeve, enteve ose strukturave organizative. Punë të tilla kërkojnë marrjen e vendimeve e përgjegjësive që lidhen me strategjitë e strukturës në të cilën veprohet. Duhen futur në këtë klasë profesionet imprenditoriale dhe drejtimore pavarësisht nga dimensioni i ndërmarrjes ose i organizatës si dhe legjislatorët e anëtarët e kuvendeve zgjedhore.

Punon si oficer, nënoficer, nxënës ose vullnetar në Forcat e Armatosura. U referohet të gjitha atyre veprimtarive të punës që zhvillohen nga personeli i Forcave të Armatosura (Ushtria, Marina, Aviacioni, Karabinierët) të çdo grade. Për shembull, për sa i përket Ushtrisë, u referohet të gjitha veprimtarive të kryera nga:

a) Oficerët Gjeneralë;
b) Oficerët Eprorë (Major, Nënkolonel, Kolonel ose me gradë koresponduese me Forcat e tjera të Armatosura);
c) Oficerët Deprorë (Nëntoger, Toger, Kapiten ose me gradë koresponduese me Forcat e tjera të Armatosura);
d) Nënoficerë (Rreshter e Marshall ose me gradë koresponduese me Forcat e tjera të Armatosura);
e) Kursantë (Shkolla Ushtarake, Akademi Oficerësh e Nënoficerësh);
f) Vullnetarë (me kohë shërbimi vjetor, me kohë shërbimi të shkurtër e në shërbim të përhershëm).

Pyetja 7.10

Është e nevojshme të shënoni llojin e punës së kryer (krahu ose intelektuale) duke evituar terma të përgjithshme si "punëtor" ose "nëpunës" e duke zgjedhur terma që përshkruajnë me detaje profesionin e vet. Për shembull: pediatër, avokat, sportelist, daktilograf, argat në bujqësi, farkëtar, bojaxhi, saldator, rrobaqepës, zdrukthëtar, murator, hidraulik, roje e betuar, pronar dyqani, shitës, përfaqësues tregtie, shofer kamioni, berber, portier hoteli.

Në veçanti:

• **nëpunësit e Administratës Publike** duhet të shënojnë punën e zhvilluar efektivisht, për shembull: ekonomat, arkëtar, analist programues, portier, asistent administrativ;

• **mësuesit** duhet të shënojnë llojin e shkollës ku mësojnë, për shembull: mësues në shkollën fillore, mësues në shkollën e mesme të ulët, mësues në shkollën e mesme te lartë, profesor universiteti i lëndëve juridike (profesorët e universitetit duhet të shënojnë edhe lëndën që japin), mësues në konservatorin e muzikës, mësues në akademi;

• **priftërinjtë** (kleri shekullar e religjozët) duhet të shënojnë për shembull: peshkop ipeshkvnor, vikar i famullisë, famulltar, kapelan;

• **ushtarakët e karrierës** duhet të sinjalizojnë gradën e patur dhe armën ose korpusin e përkatësisë (për shembull: tetar i parë i karabinierëve, kolonel në ushtri, kapiten i artilerisë).

Pyetja 7.11

Duhet shënuar me kryq kutia që i përket sektorit të ekonomisë në të cilin mendohet se mund të klasifikohet veprimtaria e vetme ose kryesore e stabilimentit, ndërmarrjes bujqësore, dyqanit, studios profesionale, zyrës ose entit ku punohet. Në veçanti:

• modaliteti 03: futen në këtë kategori nxjerrja e qymyrgurit, torfës, uraniumit, gazit natyror, nxjerrja e gurëve, mermerit, zhavorrit, rërës, etj.;

• modaliteti 05: futen në këtë kategori industria e peliçeve dhe fabrikimi i artikujve për udhëtim, çanta, artikuj lëkure, punishte për takëme kuajsh e këpucësh;

• modaliteti 06: futen në këtë kategori edhe industria e prodhimeve prej tape, kashte dhe e materialeve të thurura;

• modaliteti 09: përfshihet edhe fabrikimi i makinerive dhe i aparaturave elektrike, elektronike dhe optike dhe riparimi i materialeve hekurudhore;

• modaliteti 10: përfshihet edhe fabrikimi i gurëve të çmuar, instrumenteve muzikore, lojrave, etj.;

• modaliteti 13: me tregti kuptohet si tregtia me pakicë ashtu edhe tregtia me shumicë;

• modaliteti 17: futen në këtë kategori telefonia, internet provider, etj.;

• modaliteti 19: përfshihet riparimi i perpunuesve;

• modaliteti 20: futen në këtë kategori edhe shërbimet ndaj ndërmarrjeve, qendrat e përgjigjeve telefonike, reklamat, etj.;

• modaliteti 21: futet në këtë kategori edhe INPS (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore);

• modaliteti 24: përfshihen edhe organizatat fetare;

• modaliteti 25: midis veprimtarive argëtuese, kulturore e sportive futen veprimtaritë e zbavitjes dhe spektaklit, agjencitë e shtypit, bibliotekat, kopshtet zoologjike, etj..

Pyetja 7.12

Duhet saktësuar veprimtaria e vetme ose kryesore e zhvilluar në stabiliment (e jo në ndërmarrjen që mund të ketë disa stabilimente), ndërmarrja bujqësore, ofiçina, laboratori, miniera, kantieri, punishtja, dyqani, agjencia, enti, instituti, zyra, shoqata, etj., pranë të cilit personi punon. Përgjigjja duhet dhënë në mënyrë të saktë e të detajuar. Për

shembull, duhet shënuar: kultivim perimesh, rritje gjedhësh, prodhim çimentoje, fabrikim dyersh e dritaresh prej druri, riparim automjetesh, ofiçinë elektroauto, ndërtim godinash, prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike, tregti me shumicë e cohave, tregti me pakicë e frutave dhe zarzavateve, bar, restorant, dyqan barnash mjekësore, magazina të mëdha, qoshk gazetash, ambulancë e mjekut privat, lavanderi.

Saktësohet se:

• ai që është i ngarkuar me shërbimet ndaj një familjeje (shërbyes, bashkëpunëtor familjar) duhet të shënojë "Shërbime shtëpiake" ;

• personeli shkollor pedagogjik ose jo duhet të shënojë llojin e shkollës dhe jo emrin (për shembull: çerdhe, shkollë fillore, shkollë e mesme, lice, universitet për moshën e tretë) ;

• vartësit e ndërmarrjeve autonome të shtetit duhet të shënojnë, për shembul, ANAS (Ndërmarrja Kombëtare Autonome e Rrugëve), Administrata e Monopoleve të Shtetit;

• vartësit e tjerë të Administratës Publike duhet të shënojnë emrin e Ministrisë, Administratës, Zyrës, Entit, etj. pranë të cilave zhvillojnë veprimtarinë e vet të punës (Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Brendshme, Administrata Komunale, Administrata e Gjykatave Ushtarake, Doganat);

• profesionistët e lirë dhe punonjësit më vete duhet të shënojnë llojin e veprimtarisë së ushtruar (për shembull: studime arkitekture, konsulenca pune, administrim projektesh në fushën e ndërtimeve, instalim impiantesh hidrauliko-sanitare, instalim impiantesh ngrohjeje, administrim projektesh në fushën e ajrit të kondicionuar).

8. Vendi i studimit ose i punës

Pyetja 8.1

• Shënoni me kryq kutine 1 ("Po, shkon në vendin e studimit") edhe për fëmijët që frekuentojnë çerdhen, kopshtin, etj.

• Shënoni me kryq kutine 6 ("Jo, sepse nuk studjon ose nuk punon ose nuk frekuenton kurse kualifikimi profesional") edhe nëse personi shoqëron çdo ditë fëmijët në shkollë por më pas nuk shkon në një vend pune ose studimi.

Pyetja 8.2

Duhet të përgjigjet vetëm ai që shkon çdo ditë në vendin e studimit ose të punës ose ai që ka shënuar kutine 1 ("Po shkon në vendin e studimit" ose kutine 2 ("Po, shkon në vendin e punës") pyetjes 8.1.

Pyetja 8.4

• Mund të mos ketë lidhje midis vendit të punës dhe përgjigjes së dhënë pyetjes 7.12: është rasti, për shembull, i vartësit të një firme sipërmarrëse të shërbimit të mirëmbajtjes pranë një stabilimenti metalurgjik, i cili duhet të shënojë adresën e stabilimentit e jo atë të firmës nga e cila varet.

• Në rastin e ndërmarrjeve në të cilat emri i ndërmarrjes përputhet me emrin e titullarit të saj mjafton të shënoni fjalët "ndërmarrje individuale".

• Në rastin e profesionistëve të lirë shënoni "profesionistë të lirë".

• Pasi keni shënuar emrin dhe adresën e vendit të zakonshëm të studimit ose të punës, është e nevojshme të shënoni edhe nëse ai gjendet në komunën ku banoni, në komunë tjetër ose jashtë shtetit, duke shënuar me kryq kutine përkatëse.

Pyetjet 8.5, 8.6 e 8.7

• Duhet t'u përgjigjet këtyre pyetjeve vetëm ai që të mërkurën e kaluar ka shkuar në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës.

• Në qoftë se personi ka shkuar në një vend studimi ose pune <u>të ndryshëm nga ai i zakonshmi</u> i treguar paraprakisht <u>nuk</u> duhet t'u përgjigjet pyetjeve.

SEKSIONI III – TË DHËNA PËR PERSONAT QË NUK KANË VENDBANIM TË ZAKONSHËM NË BANESË

1. Të dhëna të gjendjes civile

Pyetjet 1.2 e 1.3

Shiko shënimet lidhur me pyetjet 1.3 e 3.1 të Seksionit II.

2. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi që banojnë jashtë shtetit

Pyetjet 2.1 e 2.2

Duhet të përgjigjen shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi që kanë <u>vendbanim të zakonshëm jashtë shtetit</u>.

Përsa i përket arsyes së pranisë në Itali:

a) duhet të shënojnë me kryq kutine 1 ("Punë") edhe ata që, ndonëse kanë ardhur në Itali për të punuar, janë ende pa punë;

b) duhet të shënojnë me kryq kutine 2 ("Studim") ai që ka ardhur në Itali për të ndjekur një kurs studimi që nuk e ka mbaruar ende, edhe nëse nuk përjashton të mbesë për të punuar pasi të ketë marrë titullin eventual të studimit;

c) duhet të shënojnë me kryq kutine 3 ("Prania e familjarëve") vetëm ata që kanë ardhur në Itali për t'u bashkuar me familjarët (për shembull gruaja që shkon te burri i cili punon në Itali). Kjo kuti nuk duhet të shënohet nga ata që janë në kërkim të një pune e që kanë zgjedhur Italinë meqënëse aty ishte vendosur prej kohësh një i afërm në gjendje për t'i ndihmuar;

3. Prania dhe vendbanimi

Pyetja 3.1

Shiko shënimet lidhur me pyetjet 4.1 të Seksionit II.

4. Gjendja profesionale ose jo profesionale dhe veprimtaria e punës

Pyetja 4.1

Midis personave në kërkim të punës futen:

a) personat në kërkim të punës së parë;

b) të papunët në kërkim të një pune të re;

c) personat në pritje për të filluar një punë që e kanë gjetur prej kohe.

Për të gjitha modalitetet shiko shënimet lidhur me pyetjen 6.1 të Seksionit II.

Pyetja 4.2

Shiko shënimet lidhur me pyetjen 7.11 të Seksionit II.

5. Vendi i studimit ose i punës

Pyetja 5.1 e 5.2

Shiko shënimet lidhur me pyetjen 8.1 e 8.2 të Seksionit II.

Pyetjet 5.4, 5.5, 5.6 e 5.7

Shiko shënimet lidhur me pyetjet 8.4, 8.5, 8.6 e 8.7 të Seksionit II.